

PROTOKOLLI

PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT KËRKIMOR-SHKENCOR DHE ARTISTIK MIDIS AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË DHE AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS

Akademia e Shkencave e Shqipërisë (në vazhdim ASHSH) dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (në vazhdim ASHAK), në zbatim të Marrëveshjes së bashkëpunimit kërkimor-shkencor dhe artistik të vitit 2000, për vitet 2007-2009, ranë dakord të zhvillojnë këto veprimtari të përbashkëta:

1. **Konferencë shkencore “Studime filologjike shqiptare”, ASHAK** (Seksioni i Gjuhësisë dhe Letërsisë), në bashkëpunim me ASHSH (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë), Prishtinë, 2007;
2. **Çështje të standardizimit të shqipes dhe të terminologjisë – veprimtari të Këshillit Ndërakademik.** Bashkëpunim i vazhdueshëm midis ASHSH (IGJL) dhe ASHAK (SGJL) për harmonizimin e qëndrimeve në këtë fushë;
3. **Enciklopedia Shqiptare.** Projekt i përbashkët i dy Akademive, 2007 e në vazhdim;
4. **Enciklopedia e artit shqiptar.** Botim i përbashkët i ASHSH (QSA) dhe ASHAK (SA), 2007 e në vazhdim;
5. **Tryezë shkencore “Çështje të morfosintaksës historike të shqipes”, ASHAK** (Seksioni i Gjuhësisë dhe Letërsisë), në bashkëpunim me ASHSH (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë), Prishtinë, 2007;
6. **Shënimi i 100 vjetorit të Kongresit të Manastirit**, ASHAK dhe ASHSH, 2008;
7. **Përfaqësuesit e pedagogjisë së Rilindjes Kombëtare, ASHAK (SSHSH) në bashkëpunim me ASHSH, 2007-2008;**
8. **Kërkime arkeologjike në Kosovë.** Përpilimi i Hartës arkeologjike, II. Gërmime arkeologjike në Rrafshin e Kosovës. Projekt i përbashkët i Muzeut të Kosovës dhe Institutit Arkeologjik të Tiranës (financimi i përbashkët i këtyre institucioneve), 2007 e në vazhdim;
9. **Veshjet popullore të Kosovës.** Vazhdim i korpusit të veshjeve popullore. Volumi V. Projekt studimor dhe botim i Albumit përkatës i Institutit Albanologjik të Prishtinës dhe Institutit të Kulturës Popullore të ASHSH, 2007 e në vazhdim;
10. **Arkitektura popullore tradicionale shqiptare** (aspekti etnografik). Përgatitja e vëllimit II: “Venbanime dhe banesa popullore në Kosovë”. Projekt i përbashkët i ASHAK (Seksioni i Shkencave Shoqërore) dhe Institutit të Kulturës Popullore të ASHSH, 2007 e në vazhdim;
11. **Fjalor me fjalë dhe me shprehje popullore.** Hartimi dhe botimi i fjalorit. Projekt i përbashkët i ASHSH (IGJL) dhe Institutit Albanologjik të Prishtinës, 2007 e në vazhdim;
12. **Fjalor shpjegues i informatikës.** Hartimi dhe botimi i Fjalorit Projekt i përbashkët i ASHAK (SGJL) dhe ASHSH (IGJL dhe INIMA), 2007 e në vazhdim;
13. **Fjalor shpjegues i termave të botanikës.** Hartimi dhe botimi i fjalorit. Projekt i përbashkët ASHAK (Seksioni i Shkencave të Natyrës) dhe ASHSH (IGJL, IKB dhe FSHN), 2007 e në vazhdim;
14. **Fjalori i terminologjisë së muzikës,** Prishtinë, 2007 e në vazhdim;
15. **Hulumtimet radiologjike në territorin e Kosovës (radioekologji), ASHAK (SSHN dhe Departamenti Fizikës i FSHMN) në bashkëpunim me ASHSH (Instituti i Fizikës Bërthamore), Prishtinë, 2007 e në vazhdim;**
16. **Klasifikimi shkencor i poezisë dhe i prozës popullore shqiptare; IKP i ASHSH-së dhe IA (Dega e Folklorit dhe Etnografisë), 2007;**

17. Konferencë për veprën shkencore të Selman Rizës , Tiranë, 2009;
18. Simpoziumi shkencor me temë: Kah po shkon arti shqiptar? ASHAK në bashkëpunim me ASHSH, Prishtinë, 2007 ose 2008;
19. Konferencë shkencore “Bashkëpunimi ekonomik Shqipëri-Kosovë në kuadrin e integritimeve rajonale e më gjerë”, Tiranë, 2008;
20. Tryezë shkencore për Mitrush Kutelin, ASHAK (Seksioni i Gjuhësisë dhe Letërsisë), në bashkëpunim me ASHSH (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë), Prishtinë, 2007;
21. Ekspozitë e përbashkët e R. Ferrit, T. Emrës dhe Gj. Gjokajt (krijimtaria më e re), ASHAK (Seksioni i Arteve) në bashkëpunim me ASHSH (Galeria Kombëtare e Arteve), Tiranë, 2008;
22. Sesion shkencor për “Gjendjen e terminologjisë shqipe dhe perspektivat e zhvillimit të saj”, IGJL i ASHSH dhe SGJL i ASHAK, Tiranë, 2007;
23. Veprimtari përkujtimore për 100-vjetorin e lindjes së prof. Eqrem Çabejt, ASHSH dhe ASHAK, Tiranë, 2008;
24. Shkëmbime informacionesh në fushë të hidrometeorologjisë, 2007 e në vazhdim;
25. Projekti “Vlerësimi i rrezikut sizmik të Kosovës”, Instituti i Sizmologjisë i ASHSH, Tiranë dhe ASHAK, 2007-2010; në këtë kuadër gjatë viteve 2007-2008 bashkëpunimi për hartimin e Katalogut të Tërmeteve të Kosovës;
26. Ekspedita të përbashkëta ndërdisiplinore, 2007 e në vazhdim;
27. Promovime veprash shkencore, 2007 e në vazhdim;
28. Shkëmbime reciproke të periodikëve dhe botimeve shkencore, 2007 e në vazhdim;
29. Ligjërata të ndërsjellta të akademikëve.

Për secilën prej veprimtarive të mësipërme do të hartohen programe të posaçme pune të miratuara nga organet përkatëse të institucioneve bashkëpunuese.


Për të ndjekur ecurinë e realizimit të veprimtarive të parashikuara në këtë Protokoll, përfaqësues të të dy palëve do të takohen të paktën një herë në vit. Vendi dhe data e takimit do të caktohen me korrespondencë.

Ky Protokoll mund të ndryshohet ose të shtohet me miratimin e të dy palëve.

Protokolli është i vlefshëm për një periudhë dyvjeçare që nga data e nënshkrimit.


Nënshkruar në Prishtinë, më 5 prill 2007, në dy kopje, me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë.

PËR AKADEMINË E SHKENCAVE
DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS



SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Akademik Hivzi Islami

PËR AKADEMINË
E SHKENCAVE
TË SHQIPËRISË



SEKRETARI SHKENCOR
Akademik Eduard Sulstarova